**REPUBLIKA E SHQIPERISË**
**BASHKIA DIBËR**
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT KONTROLLIT DHE ZHIVILLIMIT TË TERITORIT**

**Nr ____, datë 26/02/2021.**

**Për**

**"Per miratim investimesh"**

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015, dt 17.12.2015 " *Për vetqeverisjen vendore*", duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republiken e Shqipërisë" i ndryshuar dhe ligjit nr. 88/2019 datë 18.02.2019 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021", i miratuar me vendimin e Këshillit Bashiak Dibër nr. 160 datë 30.12.2020, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendim, nr. 32/1 prot. datë 14.01.2021.

**<u>KËRKOJMË:</u>**

**Miratimin e investimeve për objektet e poshtëshënuara:**

1. Rehabilitimi i kanaleve ujitëse në fshatin Katund i Ri, NJA Luzni me vlerë investimi 96.390.596 lekë me TVSH.
2. Sistemim + asfaltim rruga Arras-Lure me vlerë investimi 1.098.375 024 lekë me TVSH.
3. Ujësjellësat e fshatrave Arap i Epër+ Lishan i Poshtëm me vlerë investimi 24.772.439 lekë me TVSH.
4. Rikonstruksion kryesor i ujësjellësit të Korabit me vlerë investimi 1.113.757.723 lekë me TVSH.

**Totali i vlerës së investimeve = 2.333.295.782 lekë me TVSH.**

Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Urbanistikës, Sektori i Financës dhe Sektori i Prokurimeve.
Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

| Drejtori i Sherbime Mbeshtetese | Drejtori Urbanistikes | Drejtori Finances |
|---|---|---|
| Shkelqim MURRJA | Bedri SHEHU | Lorenc CIBAKU |

**KRYETARI BASHKISË**
**DIONIS IMERAJ**

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA DIBËR

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

**RELACION SHPJEGUES**

**KESHILLIT BASHKIAK DIBER**

Për sa i përket Projekt - Vendimit te paraqitur prane jush per miratimin e investimit te objektit: "REABILITIMI I KANALEVE UJITESE NE FSHATIN KATUND I RI NE NJESIA ADMINISTRATIVE LUZNI" Bashkia Diber, ju informojme se:

Duke pare nevojat e banoreve te fshatit Katund i Ri per vaditjen e tokes, nga ana jone i eshte bere kerkese Ministrise se Bujqesise dhe Zhvillimit rural, per miratimin e investimit te objektit:

"REABILITIMI I KANALEVE UJITESE NE FSHATIN KATUND I RI NE NJESIA ADMINISTRATIVE LUZNI"

Projekti dhe preventivi jane hartuar nga Studioja e Projektimit "2 ED" Tirane.

Vlera e preventivit eshte 96.390.596 lek me T.V.SH.

Gjatesia e pergjthshme e kanalit eshte vija e eperme L=3550 ml qe merret ne nje perrua ne kete zone me prurje rreth 7-10 l/sek ne periudhen e pikut dhe vija e poshtme L=2900 ml qe merret ne Drinin e Zi e cila siguron nje prurje rreth 110-190 l/sek.

Te dy kanalet ne gjithe gjatesine e tyre kane nevoje per nderhyrje te menjehershme, pasi jan ndertuar qe ne vitet e hershme dhe mosmirmbajtja e tyre ka shkaktuar shume probleme, duke filluar qe nga vepra e marrjes e cila momentalisht funksionon me mjete rrethanore ndersa shumica e gjatesise se kanalit ka dale jashte funksionit primar per te cilin eshte ndertuar.

Rehabilitimi i ketij kanali do te siguroje vaditjen per 482 hektar toke dhe i vjen ne ndihme nje popullsie prej afro 4567 banore , aktiviteti primar ekonomik i te cileve eshte bujqesia.

Nje investim i tille do te ndihmoje ne permiresimin e kushteve ekonomike te banoreve te Nj.A. Luzni.

Mendohet dhe eshte planifikuar nga projektuesi qe punimet nga momenti i fillimit deri ne perfundimin e tyre te zgjasin 4 muaj.

Punoi: Ing.Dorian vraniçi

Drejtori: Ing. Bedri Shehu`

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DIBËR**
**KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

**VENDIM Nr 15 Datë 03.03.2021**

**"Për miratim investimesh"**

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015, dt 17.12.2015 " *Për vetqeverisjen vendore*", duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republiken e Shqipërisë" i ndryshuar dhe ligjit nr. 88/2019 datë 18.02.2019 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021", i miratuar me vendimin e Këshillit Bashiak Dibër nr. 160 datë 30.12.2020, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendim, nr. 32/1 prot. datë 14.01.2021. Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e **datës 03.03.2021** sipas urdherit **633** datë **17.11.2020** miratoi me **19** vota pro **2** kundër **1** apstenim .

**VENDOSI :**

**Miratimin e investimeve për objektet e poshtëshënuara:**

1. Rehabilitimi i kanaleve ujitëse në fshatin Katund i Ri, NJA Luzni me vlerë investimi **96.390.596** lekë me TVSH.

2. Sistemim + asfaltim rruga Arras-Lure me vlerë investimi **1.098.375 024** lekë me TVSH.

3. Ujësjellësat e fshatrave Arap i Epër+ Lishan i Poshtëm me vlerë investimi **24.772.439** lekë me TVSH.

4. Rikonstruksion kryesor i ujësjellësit të Korabit me vlerë investimi **1.113.757.723** lekë me TVSH.
   **Totali i vlerës së investimeve te lartepermendura eshte = 2.333.295.782 lekë me TVSH.**

5. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Urbanistikës, Sektori i Financës dhe Sektori i Prokurimeve.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

Kryetar Këshilli

Sokol Sava

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DIBËR

Adresa: Bulevardi "ELEZ ISUFI", Peshkopi, email:bashkiadiber@gmail.com nr.tel:00355218

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

**Nr. 775 prot** **Peshkopi më 08.03.2021**

**LËNDA :**Dërgim vendimi për konfirmim

**DREJTUAR :**Prefektit Qarkut Dibër

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër **Nr.15**

**Datë : 03.03.2021**

**"Për miratim investimesh" 1.** Rehabilitimi i kanaleve ujitëse në fshatin Katund i Ri, NJA Luzni. **2.** Sistemim + asfaltim rruga Arras-Lure. **3.** Ujësjellësat e fshatrave Arap i Epër+ Lishan i Poshtëm. **4.** Rikonstruksion kryesor i ujësjellësit të Korabit.

**Ju faleminderit për bashkëpunimin!**

Sekretare Këshilli

Elvira TRUPJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DIBËR

Adresa: Bulevardi "ELEZ ISUFI", Peshkopi, email:bashkiadiber@gmail.com nr.tel:003552182293